

Kryeministria

Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit. Kryeministria e ka selinë në Tiranë.

Struktura dhe përbërja

1. Kryeministria përfshin: aparatin e Këshillit të Ministrave, kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit/ave të Shtetit.
2. Struktura dhe organika e Kryeministrisë përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Emërimi, lirimi ose shkarkimi i të punësuarve të kabineteve, bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e kryesuesit të kabinetit. Të punësuarit e kabineteve gëzojnë statusin e funksionarit politik.

Zëvendëskryeministri

1. Zëvendëskryeministri zëvendëson Kryeministrin, në kuptimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Zëvendëskryeministri kryen detyra, që parashikohen në ligje të veçanta, si dhe ato që i ngarkohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave është nëpunësi më i lartë civil i Këshillit të Ministrave.
2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet në detyrë sipas procedurave të parashikuara në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”.

Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:
 - a) organizon dhe asiston në mbarrëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave;
 - b) ndjek procesin e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave të Ministrave, që nga paraqitja e projektakteve për shqyrtim e derisa aktet marrin fuqi ligjore, në kuptim të Kushtetutës;
 - c) kthen, në bazë të argumenteve ligjore, projektaktet e paraqitura për shqyrtim, kur ato bien në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjin;
 - ç) i parashtron Kryeministrit përputhshmërinë e projektakteve të propozuara me legjislacionin në fuqi dhe me programin politik të Këshillit të Ministrave;
 - d) përgatit, pas këshillimit me Kryeministrin, programet afatshkurtra dhe afatmesme të veprimtarisë së Këshillit të Ministrave;

dh) drejton aparatin e Këshillit të Ministrave për të përmbushur funksionin mbështetës të veprimtarisë së Këshillit të Ministrave;

e) administron buxhetin dhe është titullar i entit prokurues të Kryeministrit.

2. Këshilli i Ministrave ose Kryeministri mund t'i caktojë Sekretarit të Përgjithshëm edhe detyra të tjera.

Institucionet qendrore

1. Institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, janë persona juridikë, publikë, që krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, për të ushtruar veprimtarinë shtetërore në një fushë të caktuar.

2. Statusi, objekti i veprimtarisë, organizimi i brendshëm, emërimi, lirimi ose shkarkimi i drejtuesit të institucionit qendror dhe çështje të tjera për to, parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, me të cilin ato krijohen.

3. Struktura dhe organika e tyre, përveç rasteve kur ato rregullohen me ligj, përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, përkatësisht për institucionet në varësi të Kryeministrit, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa për institucionet në varësi të ministrit me propozimin e këtij të fundit.

Komitetet ndërministrore

1. Komitetet ndërministrore janë organe konsultative të Këshillit të Ministrave, ku diskutohen paraprakisht politikat, çështjet e rëndësishme të veprimtarisë ekzekutive, si dhe projektaktet e një rëndësie të veçantë.

2. Komitetet ndërministrore kryesohen nga Kryeministri. Në raste të veçanta dhe me miratimin e tij mund të kryesohen nga Zëvendëskryeministri ose ministri i fushës përkatëse. Ngritja, përbërja, fusha e veprimtarisë që shqyrtojnë dhe të ftuarit në mbledhjet e tyre, përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

Grupet e punës me ekspertë

1. Grupet e punës me ekspertë për hartimin e strategjive, të politikave, të studimeve ose të projekteve të veçanta krijohen me urdhër të Kryeministrit ose të ministrit për ministritë përkatëse.

2. Ekspertë mund të caktohen edhe persona, që nuk punojnë në administratën shtetërore. Shpërblimi i ekspertëve të grupeve të punës përballohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit ose të ndihmës së huaj për atë qëllim, ndërsa masa dhe mënyra e pagesës së shpërblimit përcaktohen me urdhrin përkatës të Kryeministrit.